

V E N D I M
Nr. 342, datë 7.7.2000

PËR LËVIZJEN PARALELE DHE NGRITJEN NË DETYRË TË NËPUNËSIT CIVIL

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13,14,15 dhe 29, të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999, “Për statusin e nëpunësit civil”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Procedurat e planifikimit për plotësimin e vendeve të lira, të parashikuara nga pika 1 deri në 5, të vendimit nr.231, datë 11.5.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për pranimin në shërbimin civil dhe periudhën e provës”, shërben edhe për lëvizjen paralele dhe për ngritjen në detyrë.

2. Shpallja e konkurimit për lëvizjen paralele përmban këto të dhëna:

a) Një përshkrim të shkurtër të vendit të punës: pozicioni, sektori, drejtoria dhe institucioni;

b) Kërkesat e veçanta që duhet të plotësojnë kandidatët, në përputhje me përshkrimin e punës për vendin e lirë;

c) Pozicionet në shërbimin civil, që përfitojnë nga procedura e lëvizjes paralele;

ç) Një listë të dokumenteve që duhet të paraqiten dhe vendin ku do të paraqiten;

d) Afatin deri kur do të paraqiten dokumentet, i cili duhet të jetë më i vogël se 30 ditë nga data e botimit të shpalljes për konkurim.

dh) Mënyrën dhe kohën kur do të shpallet lista e kandidatëve, që do t’i paraqiten eprorit të drejtpërdrejtë, sipas pikës 5 të këtij vendimi.

3. Departamenti i Administratës Publike, me shpenzimet e institucionit që ka vendin e lirë, boton shpalljen e vendit të lirë në dy gazeta kombëtare, me qarkullim më të madh. Në institucionet e pavarura betimi bëhet nga departamenti, drejtoria, seksioni apo zyra e personelit.

4. Departamenti i Administratës Publike bën verifikimin e kandidatëve, të cilët, sipas fotokopjeve të dokumenteve të paraqitura përmbushin kërkesat e veçanta, të përcaktuara në shpalljen për konkurim. Në institucionet e pavarura verifikimi bëhet nga departamenti, drejtoria apo zyra e personelit.

5. Kandidatët, që plotësojnë kërkesat e veçanta, të përcaktuara në shpalljen për konkurim, renditen, nga Departamenti i Administratës Publike, në listën e kandidatëve sipas rendit alfabetik dhe i paraqiten eprorit të drejtpërdrejtë. Personat që nuk plotësojnë kërkesat e veçanta renditen në një listë tjetër, ku tregohen edhe arsyet e mosplotësimit të këtyre kërkesave. Listat e mësipërme shpallen në kohën dhe në mënyrat e përcaktuara në shpalljen për konkurim.

6. Brenda 3 ditëve nga shpallja e listave, personat e interesuar mund t’i parqesin ankesat në Departamentin e Administratës Publike, për institucionet e administratës qendrore, ose në departamentin, drejtorinë, seksionin apo zyrën e personelit, për institucionet e pavarura. Ankesat zgjidhen brenda 3 ditëve nga marrja e tyre. Paraqitja e ankesave të mësipërme nuk prek të drejtën e ankimit në komisionin e shërbimit civil.

7. Dy ditë pas zgjidhjes së ankesave apo kalimit të afatit për zgjidhjen e tyre, Departamenti i Administratës Publike, për institucionet e administratës qendrore, apo departamenti, drejtoria, seksioni apo zyra e personelit, për institucionet e pavarura, ia dërgojnë listën e kandidatëve, që plotësojnë kërkesat e veçanta, eprorit të drejtpërdrejtë, përkatës. Kandidatët nuk i nënshtrohen testimit para komiteve ad hoc.

8. Eprori i drejtpërdrejtë, sipas klasës së nëpunësit civil, përpara se të zgjedhë njërin nga kandidatët e paraqitur, zhvillon, si rregull, një bashkëbisedim me secilin prej tyre.

9. Vendimi i eprorit të drejtpërdrejtë duhet të jetë i motivuar dhe të bazohet në parimet e barazisë, të mirëbesimit dhe të mosdiskriminimit.

10. Nëse në përfundim të procedurave të pikës 7 të këtij vendimi Departamenti i Administratës Publike, për institucionet e administratës qendrore, apo departamenti, drejtoria, seksioni apo zyra e personelit, për institucionet e pavarura, vëren se asnjëri nga kandidatët nuk përmbush kërkesat e veçanta, të përcaktuara në shpalljen për konkurim, fillon procedurën e ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë, ekzistues.

11. Shpallja e konkurimit për ngritjen në detyrë përmban të dhënat sipas pikës 2 të këtij

vendimi, përveç shkronjës “c”, ku përcaktohen pozicionet e shërbimit civil, që përfitojnë nga ngritja në detyrë.

12. Procedura e ngritjes në detyrë është e njëjtë me atë të pranimi në shërbimin civil, sipas vendimit nr.231, datë 11.5.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për pranimin në shërbimin civil dhe periudhën e provës”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta